



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:056225
Datë: 14.11.2024
Numri i dokumentit: 06453278

Në çështjen juridike të:

AC-I-24-0806-A0001

Paditësit

Zh Ç, M Ç, V P Ç, D T, S T, S T, V T, B P dhe J M, të gjithë nga fshati Ll, Komuna e Graçanicës, me përfaqësues sipas autorizimin avokatin A A K, Prishtinë

Kundër :

E paditur

Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. "Dritan Hoxha", nr.55, Lakrishte, Prishtinë

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami dhe Shkelzen Sylaj, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, të paraqitur kundër Aktvendimit të Kolegjit të shkallës së parë të DHPGJS-së, C-III-21-0132, të datës 30 shtator 2024, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 14 nëntor 2024, lëshon këtë:

AKTVENDIM

- Ankesa e të paditurës refuzohet si e pabazuar.
- Vërtetohet Aktvendimi i Kolegjit të shkallës së parë të DHPGJS-së, C-III-21-0132, i datës 30 shtator 2024.

3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me datë 19 prill 2021, paditësit përmes përfaqësuesit të tyre kanë paraqitur një padi në DHPGJS kundër të paditurës, më të cilën është kërkuar përmbushja e Marrëveshjes së Arondimit të datës 29 janar 1979. Në padi kanë theksuar se paraardhësi i tyre, B M me datë 1 shkurt 1979 kishte lidhur Marrëveshje për Arondim me N.SH “Kosova Export” nga Prishtina, sipas së cilës paraardhësi ia kishte bartur KBI-së pjesën e ngastrën që gjendet në Zonën Kadastrale (ZK) Llapnasellë, me fletë posedimi të pjesës së ngastrës nr., me sipërfaqe prej 1.20.00.00 ha, klasa e 4, ndërsa KBI “Kosova Export” në Fushë Kosovë, për ngastrën e lartcekur ia kishte bartur B M në pronësi ngastrën nr., me sipërfaqe 1,00.00ha, ft.243, ZK Llapnasellë. Marrëveshja është vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prishtinë me datë 30 janar 1979. Edhe përkundër kësaj marrëveshje. Bartja nuk është bërë në regjistrin kadastral me fajin e punëtorëve të KBI “Kosova Export” në Fushë Kosovë. Në kërkesëpadi ishte kërkuar e drejta e pronësisë për ngastrën nr.. me sipërfaqe prej 4775 m2. Kësaj padie i kishin bashkëngjitur: Marrëveshjen e Arondimit Vr.. të datës . janar ., Aktvendimin për shqyrtimin e trashëgimisë të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dega në Graçanicë.

Me datë 26 korrik 2024, paditësit kishin parashtruar propozimin për caktimin e masës së sigurimit. Në këtë propozim kishin deklaruar se edhe përkundër faktit se është ushtruar padia, AKP e ka publikuar tenderin për shitje të ngastrës nr., me kulturë arë klasa 2 me sipërfaqe 4774 m2, ZK Llapnasellë dhe meqenëse ekziston rreziku i tjetërsimit ka theksuar se janë përmbushur kushtet për vendosje të masës. Këtij propozimi i kishte bashkëngjitur: Publikimin për shitje të ngastrës nr.. me kulture arë, klasa 2, me sipërfaqe 4775 m2, ZK Ll..

Me datë 26 korrik 2024, DHPGJS kishte lëshuar urdhër C-III-21-0132, si për paditësit ashtu edhe për të paditurin. Paditësve iu është kërkuar të identifikojnë ngastrën lëndore objekt ndërrimi me ekspertizë gjeodezike.

Me datë 1 gusht 2024, AKP-ja kishte paraqitur mbrojtje në propozimin për caktimin e masës së sigurimit. Në mbrojtje ishte theksuar se pala kundërshtarë e kishte kundërshtuar në tërësi propozimin për caktimin e masës së sigurimit sikur të padrejtë dhe të pabazuar në ligj. Për t’u caktuar masa e sigurimit në bazë të kërkesës së propozuesit duhet të përmbushen dy elemente në mënyrë kumulative dhe atë ekzistimi i kërkesës apo i së drejtës subjektive të tij dhe shkaktimi i

dëmit të menjëhershëm dhe të pariparueshëm. AL thekson se për parashtruesin nuk janë përmbushur në mënyrë kumulative të dy kushtet ashtu siç ka përcaktuar neni i lartcekur. Tutje, kishte theksuar se propozuesit për caktimin e masës së sigurimit nuk e kanë bërë të besueshme ekzistimin e të drejtës subjektive. Gjithashtu propozuesit nuk kanë dëshmuar para gjykatës se ka bërë të besueshme kërkesën por gjithashtu as nuk ka treguar dhe nuk ka argumentuar se çfarë dëmi do të pësonin propozuesit në rast të mos caktimit të masës së sigurimit. Në rastin konkret propozuesit e sigurimit nuk kanë vërtetuar dhe as nuk janë thirrur asnjëherë se AKP i ka shkaktuar dëm të menjëhershëm dhe të pariparueshëm. Andaj duke u bazuar në të lartcekurat i propozon gjykatës që të refuzoj si të pabazuar propozimin e propozuesve për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit.

Në parashtrësë është deklaruar se nuk janë plotësuar kushtet sipas nenit 61 të DHPGJS, për caktimin e masës së sigurimit në lidhje me të drejtën subjektive se ka gjasa reale për ta fituar rastin pasi që dëmi i shkaktuar është i pariparueshëm.

Më dt. 9 gusht 2024, AKP-ja kishte dorëzuar edhe parashtrësën e përgjigjes në padi nëpërmjet të cilës e paditura pohoi se paditësit nuk kanë dorëzuar prova të mjaftueshme me padi përveç Marrëveshjes për Arondim, përpos që paditësit është thirrur në mos zbatim të kësaj marrëveshje. Më tutje kishte theksuar se ngastra nr., ZK Ll ende gjendet në emër të N.SH-së dhe kërkojmë historiatin e pronës. AKP-ja kishte kërkuar që të refuzohet kërkesëpadija e paditësve.

Me datë 10 shtator 2024, DHPGJS kishte lëshuar një urdhër me të cilin kishte kërkuar nga përfaqësuesi i paditësve të dorëzoj në gjykatë një ekspertizë gjeodezike për identifikimin e ngastrave kadastrale që kanë qenë objekt i Arondimit-ndërrimit si dhe skicën e matjeve për këto ngastra. Për shkak se avokati nuk kishte vepruar sipas urdhrit të parë, ishte vendosur që ky urdhër ti dërgohet njërit prej paditësve J M, por dorëzimi kishte dështuar me arsyetim se adresa nuk është e saktë.

Me datë 13 shtator 2024, paditësit kishin parashtruar ekspertizën e hartuar nga ekspertja e gjeodezisë L Th D, mirëpo kjo ekspertizë nuk i përmbush kriteret e pranueshmërisë së një ekspertize gjeodezike për shkak se e njëjta është shumë e mangët, nuk është e identifikuar ngastra të cilën paraardhësit të paditësit i është marrë nga KBI, pastaj nuk janë dhënë të gjitha të dhënat gjeodezike të ngastrës lëndore për të cilën kërkohet caktimi i masës së sigurimit përveç të një skice, nuk është krahasuar gjendja faktike në terren me të dhënat gjeodezike në kadastër, nuk

është siguruar certifikata e pronësisë për njësinë kadastrale nr..si dhe nuk është dhënë asnjë shpjegim se faktikisht kush është në posedim të kësaj ngastre.

Me datë 30 shtator 2024, Kolegji i shkallës së parë të DHPGJS-së me Aktvendimin C-III-21-0132 kishte aprovuar kërkesën e paditësve si të bazuar dhe kishte vendosur caktimin e masës së sigurimit me të cilën AKP-së i kishte ndaluar tjetërsimin e ngastrës kadastrale nr.. me kulturë arë klasa 2, në sipërfaqe prej 4774 m², Zona Kadastrale LI, Komuna e Graçanicës, me arsyetim se janë plotësuar kushtet nga neni 61 të Ligjit për DHPGJS. Kjo për faktin se paditësit kishin parashtruar prova të mjaftueshme dhe në këtë mënyrë i kishin vërtetuar pretendimet e tyre dhe atë nga provat si Marrëveshja për Arondim Vr.. e datës . janar .. si dhe tendenca e manifestuar nga AKP për shitjen e patundshmërisë në fjalë.

Me datë 15 tetor 2024, e paditura (ankuesja) kishte paraqitur një ankesë kundër Aktvendimit, C-III-21-0132 të datës 30 shtator 2024, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke i propozuar Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së që ankesën e kundër propozueses ta aprovoj si të bazuar dhe Aktvendimin e ankimuar ta prishë dhe çështja t'i kthehet DHPGJS-së në rishqyrtim dhe rivendosje apo që i njëjti të ndryshohet dhe propozimi për masë të sigurisë të refuzohet si i pabazuar. Ankuesja në ankesë kishte theksuar se Aktvendimi i ankimuar është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe se arsyet e dhëna janë në kundërtënie me përmbajtjen e provave. Në rastin konkret ekziston mungesa e shkakut ligjor dhe shkakut faktik. AKP-ja pretendimet për caktimin e masës së sigurisë i ka ndërtuar vetëm në supozime kinse do të shkaktohet dëm i riparueshëm në ngastrën kadastrale që është objekt kontestimor nëse nuk caktohet masa e sigurisë. Sipas ankesës provat dhe pretendimet e paditësve në rastin konkret nuk qëndrojnë ndërsa prova e parashtruar dhe atë Marrëveshja e Arondimit, Vr.. e datës . janar ., nuk i përmbushë në mënyrë kumulative kushtet e parapara në kuptim të dispozitës së nenit 61 të Ligjit për DHPGJS. Nga arsyet e paraqitura në ankesë, e paditura kishte theksuar se gjykata ka bërë shkelje thelbësore të procedurës kontestimore, konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale me rastin e vendosjes së masës së sigurimit dhe i kishte propozuar gjykatës si më lartë.

Me datë 30 tetor 2024, paditësit kishin paraqitur përgjigje në ankesë në të cilën i kishin propozuar Kolegjit të Apelit që ankesa e AKP-së të refuzohet si e pabazuar dhe të vërtetohet Aktvendimi i ankimuar.

Arsyetimi ligjor

Ankesa, AKP-së, refuzohet si e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktvendimi i ankimuar i Kolegjit të Shkallës së parë të DHPGJS-së, është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj duhet të vërtetohet.

Kriteret se kur duhet të lëshohet Masa e Sigurisë përcaktohen në nenin 61.1 të Ligjit për Dhomën e Posaçme: Pala duhet të ofrojë dëshmi të besueshme se do të rezultojë me humbje dhe dëmtim të drejtpërdrejtë dhe të pariparueshëm nëse nuk miratohet kërkesa. Këto kriteret janë përcaktuar në atë mënyrë që nëse ndonjëra nga të mësipërmet mungon, kërkesa do të refuzohet.

Kërkesa për dëshmi të besueshme i përmban që të dyja: fumus boni iuris (probabiliteti se ekziston e drejta e kërkuar presupozimi i bazës së mjaftueshme ligjore), dhe periculum in mora (rreziku i dëmtimit të pashmangshëm dhe i pariparueshëm ndaj kësaj të drejte), pasi që humbja dhe dëmtimi i drejtpërdrejtë dhe i pariparueshëm mund të ndodhë vetëm nëse ekziston në të vërtetë e drejta e pretenduar (shih jurisprudencën e përhershme të Kolegjit të Ankesave të DHPGJS-së: cf., inter alia, ASC-10-0079, ASC-10-0081, ASC-10-0017, ASC-10-0049, ASC-10-0088).

Me fjalë të tjera: Paditësi/Ankuesi i cili kërkon Masë të Sigurisë duhet të dëshmoj probabilitetin se 1) ekziston rreziku i të drejtës të cilën e kërkon, dhe 2) e drejta është në rrezik të drejtpërdrejtë të humbjes ose dëmtimit të pariparueshëm, nëse nuk lëshohet Masa e Sigurisë e cila kërkohet.

Në këtë lëndë, Kolegji i Apelit vëren se paditësit me padinë e tyre të dorëzuar në DHPGJS me datë 19 prill 2021, kanë kërkuar që të vërtetohet e drejta e tyre e pronësisë për ngastrën nr., ZK Ll, në sipërfaqe prej 4774 m², Komuna e Graçanicës.

Paditësit padinë e tyre pronësore e mbështesin në Marrëveshjen e Arondimit Vr. të datës . janar të vërtetuar në Gjykatën Komunale Prishtinë, Dega në Graçanicë, nr. 205/08, të datës 16 janar 2008, e cila kontratë ishte lidhur mes paraardhësit të paditësve B M dhe NSH-së KBI Kosova Export, Fushë Kosovë .

Duke u bazuar në provat e cekura deri në këtë fazë të procedurës, paditësit kanë dëshmuar se ata mund të kenë probabilitet të lartë për të dalë suksesshëm në padinë e tyre, lidhur me të drejtën e pretenduar pronësore.

Kolegji i Apelit konstaton se mandati ligjor i AKP-së është shitja e pronave të cilat ajo administron. Për më tepër NSH KBI “Kosova Export” në Fushë Kosovë është në likuidim, dhe AKP-ja për ta përfunduar këtë proces mund ta shes pronën kontestuese tek personat e tretë ende pa vendosur lidhur me meritat e padisë, që do të pamundësonte paditësve kthimin e kësaj prone në emrin e tyre, nëse ata dalin të suksesshëm në padinë e tyre, për çka ka probabilitet të lartë se ata do të dalin suksesshëm në padinë e tyre.

Prandaj nga arsyet e cekura, Kolegji i Apelit e mbështetë konstatimin e Kolegjit të shkallës së parë se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 61.1 i LDHP-së që të caktohet masa e sigurisë, dhe të mbrohet kjo pronë nga shitja deri sa të vendoset në merita të padisë.

Prandaj nga këtë arsye, ankesa e AKP-së refuzohet si e pa bazuar dhe vërtetohet Aktvendimi i ankimuar i Kolegjit të Shkallës së parë si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Ky Aktvendim në asnjë mënyrë nuk prejudikon zgjidhjen e meritave të padisë.

Nga sa u tha më sipër e në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur si në dispozitiv.

Taksa Gjyqësore

Ankuesja tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore me datë 22 tetor 2024, në shumë prej 100.00 euro, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit të DHPGJS, 14 nëntor 2024. .

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues _____